



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo



Komuna e Prishtinës
Opština Prishtina - Municipality of Prishtina

KOMUNA E PRISHTINËS
KRYETARI I KOMUNËS

Në bazë të nenit 13 të Ligjit për vetëqeverisje lokale 03/L - 040 ("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës", nr 28/15, qershor 2008) dhe të nenit 53 të Statutit të Komunës së Prishtinës, 01. Nr. 110 - 391, të dt. 25.2.2010, Kryetari i Komunës së Prishtinës, me datën 28 korrik 2016, merr këtë

V E N D I M

1. Komuna e Prishtinës merr vendim që të subvencionojë prindërit të cilët kanë regjistruar fëmijët e tyre në çerdhen me bazë në komunitet "SOS Kopshti".
2. Subvencionimi i SOS Kopshtit do të bëhet në bazë të kategorive si në vijim:
 - Fëmijët e braktisur që jetojnë nën përkujdesje të SOS fshatit -të subvencionohet me 50 euro për fëmijë
 - Fëmijët me nevoja të veçanta - të subvencionohet me 50 euro
 - Prindërit me të ardhura mujore deri në 500 euro, të subvencionohet me vlerë 50 euro në muaj për fëmijë.
 - Prindërit me të ardhura mujore deri në 700 euro, të subvencionohet me vlerë 30 euro në muaj për fëmijë.
 - Prindërit me të ardhura mujore deri në 1000 euro, të subvencionohet me vlerë 20 euro në muaj për fëmijë.
 - Prindërit me të ardhura mujore mbi 1000 euro nuk do të subvencionohen nga Komuna

OBLIGOHEN Drejtoria e Arsimit dhe Drejtoria për Financa ta zbatojnë këtë vendim.

Ky vendim hyn në fuqi në ditën e nxjerrjes së tij.

ARSYETIM

Për shkak të pamundësisë financiare të shumë prindërve për të përballuar koston e çerdheve publike dhe atyre me bazë në komunitet, Kryetari i Komunës vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

I DORËZOHET:

- Drejtorisë së Arsimit;
- Drejtorisë për Financa; dhe
- Qendrës për shërbim me qytetarë.

KRYETARI I KOMUNES
Shpend Ahmeti

